



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës
Mbledhja nr. 9
Prishtinë, me 21 janar 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

**I mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Džezair Murati, Suzan Novoberdaliu, Ramadan Gashi, Besa Gaxherri dhe Radmilla Vujoviç.

Munguan: Kolë Berisha, Hydajet Hyseni, Fatmire Berisha dhe Ismet Beqiri.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të 11. 11. 2008
3. Miratimi i Raportit të punës të Komisionit i vitit 2008
4. Shqyrtimi i Rregullores së Kuvendit
5. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 11. 11. 2008

Procesverbali i mbledhjes së 11. 11. 2008 u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit të punës të Komisionit i vitit 2008

Raporti i punës i Komisionit i vitit 2008 u miratua pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i Rregullores së Kuvendit

Në këtë pikë kryesuesi i mbledhjes tha: Ne do t'i marrim vërejtjet që na vijnë nga deputetët dhe do t'i futim vetëm ato që mendojmë se mund të merren parasysh. Pastaj do t'i qesim në Komision për t'u vlerësuar. Gjithashtu desha t'ju njoftoja se në bashkëpunim me NDI-në, do ta kemi një *work shop* në Batllavë, ku do ta përfshinim projektregulloren. Ky *work shop* është paraparë të mbahet në javën e parë të shkurtit. Po ashtu do të kërkoja nga ju, sepse në Komision ka anëtarë nga secili grup parlamentar, të kërkonin nga grupet tuaja parlamentare, që sa më parë t'i dërgojnë vërejtjet, nëse kanë.

Suzana Novoberdaliu - Unë kam pritur se do të kemi më shumë propozime ose vërejtje, sepse në leximin e parë ka pasur shumë kritika, ndërsa kur po vjen koha t'i qesim në letër, nuk po ka asgjë konkrete. Nuk kamë pritur që deri tani t'i kemi vetëm dy vërejtje, por sido që të jetë, do të thotë se puna jonë ka qenë e mirë.

Kryesuesi - Në javën e ardhshme do të mblidhemi me grupin e punës, do t'i shqyrtojmë propozimet, pastaj në *work shop* do t'ia paraqesim Komisionit.

5. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk pati çështje për diskutim.

Mbledhje përfundoi në orën 10:40

Ahmet Isufi

Kryetar i Komisionit për
Mandate, Imunitete dhe Rregullore të
Punës të Kuvendit

Përgatiti:
Njësia Mbështetëse e Komisionit